

**LIGJI Nr. 04/L-058  
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN  
E SUBJEKTEVE POLITIKE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-174 PËR FINANCIMIN E  
SUBJEKTEVE POLITIKE**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010).

**Neni 2**

1.Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3. ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

3.Shuma e mjeteve buxhetore dedikuar Fondit për mbështetjen e subjekteve politike nuk mund të kalojë 0.34% të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

2.Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 4.fshihet nga teksti i ligjit

**Neni 3**

Neni 8 i ligjit bazik, paragrafi 1. ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.Mjetet nga fondi mund të përdoren për këto qëllime:

1.1.financimin e aktiviteteve të rregullta të subjekteve politike;

1.2.financimin e degëve të subjekteve politike;

1.3.financimin e njësive përkatëse të organizimit të grave dhe të rinjve të subjekteve politike;

1.4.financimin e aktiviteteve parazgjedhore e zgjedhore të subjekteve politike;

1.5.financimin e aktiviteteve të grupeve parlamentare.

**Neni 4**

1.Neni 10 i ligjit bazik, paragrafi 2. nën-paragrafi 2.2. ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

2.2. 10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet e tjera politike të regjistruara dhe të certifikuara nga Komisioni qendror i zgjedhjeve, për zgjedhjet përkatëse.

2.Neni 10 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet një paragraf i ri 3. me tekstin si në vijim:

3.Subjekti politik i cili përfiton mjete financiare në pajtim me paragrafin 2. të nenit 10 të këtij ligji, nëse nuk merr pjesë në zgjedhjet përkatëse, është i obliguar ti kthejë mjetet në buxhetin e Kosovës.

#### **Neni 5**

Neni 11 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet një paragraf i ri 3. me tekstin si vijon:

3.Ndalohet dhënia e donacioneve nga të cilat dhuruesi në mënyrë të qartë mund të përfitoj ndonjë avantazh ekonomik. Donacionet e personave fizik dhe juridik për subjekte politike duhet të bëhen në mënyrë transparente në llogari bankare dhe duhet të përfshihen në raportet financiare të subjekteve politike përfituese. Raporti financiar i subjekteve politike duhet të përmbajë emrin dhe numrin e regjistrimit për personat juridike apo emrin, mbiemrin dhe adresën për personat fizikë.

#### **Neni 6**

Neni 15 i ligjit bazik, pas paragrafit 4. shtohet një paragraf i ri 5. me tekstin si në vijim:

5.KQZ-ja përgatit raport vjetor për Kuvendin e Republikës së Kosovës për shpërndarjen dhe shpenzimin mjeteve nga Fondi, më sa largu deri me datën 30 qershor të vitit pasardhës.

#### **Neni 7**

Neni 21 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.Subjekti politik gjobitet në shumën prej pesëmijë (5.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro, ndërsa kandidati për kryetar komune, kandidati për deputet, këshilltar komunal dhe kandidati i pavarur, gjobitet prej njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro, për shkelje të dispozitave të këtij ligji në qoftë se:

1.1.pranon mjete financiare në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

1.2.mban shënimet në regjistrat e veta në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

1.3.nuk i përmbahen dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave tjera të ligjeve tjera në fuqi, për zgjedhjet e përgjithshme dhe zgjedhjet lokale.

2.Një subjekt politik, i cili nuk e paraqet raportin vjetor financiar KQZ-së brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, humb të drejtën për të përfituar nga fondi në vitin e ardhshëm.

3.Personat përgjegjës brenda subjektit politik dënohet me gjobë prej njëmijë (1.000) deri në pesë mijë (5.000) Euro.

4.Subjektet politike të cilat nuk mund të dëshmojnë origjinën e të hyrave mbi njëzetmijë (20.000) Euro do të gjobiten me trefishin e asaj shume.

5.Nëse në keqpërdorim të fondeve është i përfshirë kandidati apo subjekti politik dhe mund të vërtetohet se fitimi i mandatit/mandateve është si rezultat i keqpërdorimit të fondeve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, kandidati apo subjektit politik mund edhe t'i merret mandati.

6.Subjektet Politike kanë të drejtë ankese ndaj dispozitave ndëshkimore. Ankesat i drejtohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në bazë të legjislationit në fuqi.

7.Të hyrat nga gjobat sipas këtij ligji derdhen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

#### **Neni 8**

Neni 23 i ligjit bazik ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

KQZ sipas nevojës nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

#### **Neni 9**

Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-058**  
**21 dhjetor 2011**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-055-2011, datë 30.12.2011 nga Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga.**